665/22

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
Nr. 376/23
Date/Datum 12.04.2023

K.Dh.Sh.II.nr.534/2023

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija-Ymeri dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit Fitim R. Bilalli B.I, me seli në Prishtinë, Rr. "Shefqet Shkupi", p.n, me numër të biznesit 810207599, të cilin e përfaqëson me autorizim Shoqëria e Avokatëve "Pro Juris" me seli në Prishtinë, kundër të padituruve Organi Shqyrtues i Prokurimit (më tej: OSHP) me seli në Prishtinë, rr. "Migjeni", dhe Agjencia për Menaxhim Emergjent (më tej (AME) me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulimin e aktvendimit me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të padituës, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.64/2023 të datës 27.02.2023 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.03.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Fitim R. Bilalli B.I, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.64/2023 të datës 27.02.2023, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr.64/2023 të datës 27.02.2023, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit Fitim R. Bilalli B.I, me seli në Prishtinë, Rr. "Shefqet Shkupi", p.n, me të cilin ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të PSH.nr.665/22, të datës 10.01.2023, të nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, deri në vendosjen meritore për çështjen kryesore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Me ankesë ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta anulojë aktvendimin e atakuar ashtu që të obligohet OSHP dhe AME a aprovojë propozimin për caktimin e masës së përkohshme për shtyrje të ekzekutimit të vendimit.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim

REPUBLIKA E KOSOVËS GJYKATA KOMERCIALE KOMERCIJALNI SUD REPUBLIKA KOSOVA

të nenit 13 par. 6 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe Nenit 194 të LPK-së, dhe gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi - propozuesi, në gjykatën e shkallës së parë ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit PSH.nr.665/22, të datës 10.01.2023, i nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, si dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të tij, deri në vendosjen meritore për çështjen kryesore

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ i Gjykatës Komerciale me aktvendimin e atakuar KA.nr.64/2023 të datës 27.02.2023, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit Fitim R. Bilalli B.I, me seli në Prishtinë, Rr. "Shefqet Shkupi", p.n, me të cilin ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të PSH.nr.665/22, të datës 10.01.2023, të nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, deri në vendosjen meritore për çështjen kryesore. Gjykata e Shkallës së parë në arsyet e aktvendimit të ankimuar ka theksuar se pretendimet e paraqitura në propozim, paditësi nuk i ka mbështetur në asnjë provë materiale dhe nuk ka propozuar asnjë provë me të cilat do të vërtetohej se cili është dëmi konkret dhe si është i matshëm ky dëm që i shkaktohet paditësit, dhe i cili dëm vështirë do të riparohej, ashtu që nuk e ka bërë të besueshme kërkesën e tij mbi ndonjë bazë reale se ekzekutimi i vendimit paditësit do ti sillte ndonjë dëm vështirë të riparueshëm. Po ashtu, në arsyet e dhëna në aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se dëmi i cili pretendohet nga paditësi është dëm material i cili nuk është vështirë i riparueshëm duke marrë për bazë që si i padituri është institucion shtetëror dhe në rast të caktimit të dëmit nga gjykata i njëjti mund të realizohet pa vështirësi. Po ashtu, gjykata i ka vlerësuar si të pabazuara edhe pretendimet e paditësit se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik, pasi që gjykata vlerëson se në këtë rast me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit do të pezullohej aktiviteti i prokurimit "Furnizim me Aparate të Frymëmarrjes dhe Bombola të Ajrit", deri në vendosjen meritore për çështjen kryesore, ashtu që do t'i pamundësonte autoritetit kontraktues që të vazhdojë tutje lidhur me aktivitetin e lartcekur, veprim ky që do ishte në kundërshtim me interesin publik.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Kolegjit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se me asnjë provë materiale paditësi nuk ka arritur të provojë faktin se cili është dëmi konkret dhe si është i matshëm ky dëm që i shkaktohet paditësit, dhe së çfarë dëmi vështirë do të riparohej. Arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë në vendimin e atakauar drejtë ka konstatuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me një proces të prokurimit publik i cili është në interes publik dhe se paditësi nuk ka arritur të vërtetojë faktin se të njëjtit mund t'i shkaktohet dëm vështirë i pariparueshëm. Në këtë drejtim, gjykata drejtë dhe bazuar në dispozitat e Nenit 22 të LKA ka konkluduar se shtyrja eventuale e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin

REPUBLIKA E KOSOVËS GJYKATA KOMERCIALE KOMERCIJALNI SUD REPUBLIKA KOSOVA

publik, pasi që në rastin konkret me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit do të pezullohej aktiviteti i prokurimit "Furnizim me Aparate të Frymëmarrjes dhe Bombola të Ajrit" dhe padyshim që do t'i pamundësonte autoritetit kontraktues që të vazhdojë tutje lidhur me aktivitetin e lartcekur, veprim ky që do ishte në kundërshtim me interesin publik.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të propozuesit- paditësit, në ankesë, të cekura më lartë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe sipas vlerësimit të Kolegjit nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Andaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktvendimit nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura, dhe se nuk i ka konstatuar drejt gjendjen faktike, janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së,u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.534/2023, me datë 30.03.2023

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova

Republika e Kosovës Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE
Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik